



I financuar pjesërisht nga kontributi zemërgjerë i Zvicrës, Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) synon të promovojë të kuptuarit e mandatit dhe procedurave të DHSK-së dhe të kultivojë dialog në Kosovë dhe rajon për punën që kryen. Drejtuesit e DHSK-së e kanë përcaktuar komunikimin dhe ndërgjegjësimin si një përparësi kyçe në punën e gjykatës. Prandaj, përveç ngjarjeve të zhvilluara nga ekipi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit çdo muaj, drejtuesit bëjnë të gjitha përpjekjet për t'u angazhuar personalisht me shoqërinë civile në baza të rregullta. Programi për Komunikim dhe Ndërgjegjësim synon të informojë publikun për DHSK-në dhe t'u japë njerëzve mundësinë që të bëjnë pyetje dhe të shprehin shqetësimet e tyre. Rrjeti Informues i Gjykatës (RRIGJ) u krijua për të mundësuar mbledhjen e mendimeve dhe mbështetje për Programin për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së dhe përbëhet nga disa organizata të shoqërisë civile dhe organizata joqeveritare nga Kosova dhe Serbia. (fotografi: Kryetarja Ekaterina Trendafilova dhe Administratorja Fidelma Donlon gjatë një takimi të komunikimit dhe ndërgjegjësimit me shoqërinë civile dhe median në Prishtinë, shtator 2021).

RRJETI INFORMUES I GJYKATËS (RRIGJ)

DHSK-ja themeloi Rrjetin Informues të Gjykatës (RRIGJ) të përbërë nga 15 OJQ nga Kosova dhe Serbia. Falë këtyre partneriteteve, DHSK-ja është në gjendje të komunikojë me një larmi pjesëmarrësish. Përmes kontakteve të rregullta me rrjetin, DHSK-ja pranon vazhdimisht mendime lidhur me Programin e saj për Komunikim dhe Ndërgjegjësim dhe komunikimet.

KOMUNIKIM I NDËRSJELLË

Përhapja e informacionit të saktë është vetëm një prej aspekteve të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së. Përgjigja ndaj pyetjeve dhe diskutimi i keqkuptimeve të mundshme në lidhje me punën e gjykatës, në dialog me qytetarët, është po aq e rëndësishme. DHSK-ja konsultohet rregullisht me shoqërinë civile lidhur me veprimtaritë e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim me qëllim që të informojë sa më shumë njerëz me informacione të qarta dhe të përshtatshme.

VENDOSJA E KOMUNIKIMIT ME NJERËZIT

Pyetjet, shqetësimet dhe mendimet e shprehura në ngjarjet e komunikim-ndërgjegjësimit mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe interesimesh. Duke pasqyruar këtë diversitet, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së kryen aktivitetet e tij në të gjithë Kosovën dhe komunikon me sa më shumë njerëz të jetë e mundur.

Në mënyrë që të rritet ndikimi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim, janë paraparë aktivitete me pjesëmarrës specifik dhe me publikun e gjerë. Përmes këtyre aktiviteteve DHSK-ja bisedon drejtpërdrejt me të rinj, përfaqësues të komunitetit, shoqërinë civile, studentë, gazetarë, juristë dhe të tjerë.



Zëdhënësi Michael Doyle në një intervistë televizive për kanalin televiziv gjerman ARD.

KONTAKTI

Veprimtaritë komunikuese dhe ndërgjegjësuere të DHSK-së synojnë ofrimin e informacioneve të cilat i përshtaten interesimeve të pjesëmarrësve dhe fazës përkatëse të procedurave gjyqësore. Që nga viti 2018, ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim ka zhvilluar vizita pothuajse çdo muaj në Kosovë për të informuar grupet e ndryshme dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve të tyre.

Brenda periudhës 2018-2022, DHSK-ja ka zhvilluar mbi 130 veprimtari komunikimi dhe ndërgjegjësimi në gjithë Kosovën, duke u lidhur drejtpërdrejt me 3000 pjesëmarrës. Gjatë pandemisë COVID-19 takimet e Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së dhe takimet me Rrjetin Informues të Gjykatës vazhduan në Internet. DHSK-ja zbaton aktivitetet e saja të komunikimit dhe ndërgjegjësimi në bashkëpunim të ngushtë me partnerët në Kosovë.



Zëdhënësjë, Angela Griep, në një videoklip të DHSK-së lidhur me "pyetje të shpeshta" (tetor 2021)

■ TAKIME ME RRIJG-JEN DHE SHOQËRINË CIVILE

Tryeza të rrumbullakëta, seminare dhe diskutime në panele të organizuara në Kosovë. Pjesëmarrësit ndryshojnë në varësi të ngjarjes dhe përfshijnë, për shembull, qytetarë të interesuar, drejtues të komuniteteve lokale dhe juristë. Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e DHSK-së bëjnë prezantime të aspekteve të ndryshme të mandatit dhe procedurave të gjykatës si dhe mundësojnë parashtrimin e pyetjeve dhe diskutime.

■ LIGJËRATA ME STUDENTË TË DREJTËSISË

Përfaqësuesit e DHSK-së u bëjnë studentëve në universitetet e tyre prezantime për gjykatën dhe nxisin diskutime.

■ VEPRIMTARI INFORMUESE PËR PJESËMARRJEN E VIKTIMAVE

Element kyç i çdo prezantimi të dhënë nga ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim është mbi pjesëmarrjen e viktimave. Ky informacion përfshin mënyrën se si personat mund të aplikojnë për të marrë pjesë në procedura si viktima, si dhe informacion mbi rregullat që rregullojnë pjesëmarrjen e viktimave.



Kryetarja dhe Administratorja në një takim përmes Internetit me RRIJG-jen (tetor 2022)

■ SEMINARE ME RININË

Seminare ndërvepruese me studentë të shkollave të larta dhe të universiteteve janë organizuar për të shpjeguar historinë e krijimit, mandatin dhe veprimtaritë e DHSK-së.

■ KOMUNIKIMI ME MEDIA DHE TRAJNIME ME GAZETARË

DHSK-ja u përgjigjet me kohë pyetjeve të mediave për të siguruar që gazetarët të raportojnë saktë dhe të marrin informacionin më të përditësuar. DHSK-ja gjithashtu mban takime me gazetarë të Kosovës dhe rajonit për t'iu informuar ata për mandatin dhe procedurat e DHSK-së. Periodikisht, DHSK-ja gjithashtu organizon ose merr pjesë në seminare për gazetarë në mbështetje të raportimit të saktë të gjykimeve dhe procedurave gjyqësore.

■ MATERIALI INFORMUES

Video-materiale të shkurta që shpjegojnë mandatin e DHSK-së dhe risitë kryesore publikohen shpesh në televizion në Kosovë, në shqip dhe në serbisht, si dhe postohen në kanalën YouTube. Gjithashtu, infografikë, fletinformacione, raporte dhe publikime të tjera janë të disponueshme në Internet, kurse kopje të shtypura të tyre shpërndahen gjatë takimeve dhe veprimtarive.

I gjithë materiali është i disponueshëm në të tri gjuhët zyrtare: anglishte, shqipe dhe serbe (duke përfshirë në alfabetin cirilik).

■ VIZITA GRUPORE NË DHSK

Në përpjekjet e veta për t'iu njohur grupet e interesuara me punën e vet sa më mirë, DHSK-ja mirëpret studentë, profesionistë të fushës së ligjit dhe çdo grup tjetër të interesuar për vizita të selisë së vet në Hagë.



Seancë informuese para studentëve të drejtësisë në Gjilan (qershor 2022)